

RAPORT I AUDITIT TE PAVARUR

**MBI AUDITIMIN E FONDEVE TE PERDORURA NE FUSHATEN
ZGJEDHORE, PER ZGJEDHJET PER KUVEND QERSHOR 2013, NGA**

SUBJEKTI

PARTIA LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM

Drejtuar:

KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE

Bulevardi ``Deshmoret e Kombit``

“Pallati i Kongreseve”, Tirane

Nga:

Stoli LAZE

Eksperte Kontabel e Regjistruar

Nr Licence 36 dt. 10.02.2000

Blv “Gjergj Fishta”,

Nd. 30, P. 18, Ap.8 PO BOX 1001

prane “Ish Ekspozites”, Tirane

**PERIUDHA E AUDITUAR: MAJ-QERSHOR 2013
KOHEZGJATJA E AUDITIMIT: 3- 27 SHTATOR 2013**

Stoli Laze - Eksperte Kontabël e Regjistruar

Cel. 069 21 73 995 Cel. 069 23 38 011

Permbajtja:

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR	3-4
ANEKSI I PARE	5
ANEKSI I DYTE	6-8
Partia "Levizja Socialist per Integrim" Pasqyra e fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore 2013	9-13
<i>Shenime per pasqyren financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera, ne fushaten zgjedhore 2013</i>	
I. Te pergjithshme	14
II. Rregullat e vleresimit	15
1. Fonde te perfituara gjate fushates zgjedhore 2013	15
1.1 Fondet Publike	15
1.2 Fondet jopublike (ne vlere monetare)	16
1.3 Donacionet e perfituara ne sende dhe sherbime te vleresuara me vlere tregu	17
1.4 Perfitime nga reklama televizive neni 84, pika 6 e Kodit Zgjedhor	17
1.5 Te tjera	17
2. Shpenzimet e kryera	18
2.1 Marrje salle me Qera	18
2.2 Reklama televizive dhe transmetime spotesh	18
2.3 Konsulenca te huaja per fushaten	19
2.4 Shpenzime telefonike	19
2.5 Shpenzime per fletevolante, fletepalosje, reklama, banderola	20
2.6 Shpenzime kancelerie	20
2.7 Te tjera	21
2.8 Sherbime per sherbime te tjera	21
2.9 Pagat e punonjesve dhe kontributet	21
3. Llogarite Bankare	22
4. Regjistrimi i fondeve jopublike te fushates	23
5. Ngjarje te mevoneshme	23

RAPORT I AUDITIT TE PAVARUR MBI ANGAZHIMET E AUDITIMIT PER QELLIME TE VECANTA.

MBI AUDITIMIN E FONDEVE TE PERFITUARA
NE FUSHATEN PER ZGJEDHJET PER KUVEND MAJ-QERSHOR 2013,
NGA SUBJEKTI **PARTIA LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM**

Drejtuar: KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE

Bulevardi "Deshmoret e Kombit"

"Pallati i Kongreseve", Tirane

Ne kemi audituar pasqyrat dhe evidencat mbeshtetese te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per fushaten zgjedhore, per zgjedhjet per kuvend ne 23 Qershor 2013 te kryera nga Partia "LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM", qe perfshin periudhen 23 Maj deri me 23 Qershor 2011 si dhe te periudhave paraardhese e pasardhese ne te cilat jane kryer veprime financiare ne dobi te fushates zgjedhore .

Pasqyrat dhe dokumentat janë përgjegjësi e drejtimit të Partise "LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM".

Paqyrat dhe librat permbledhes te aktivitetit financiar jane pergatitur nga drejtimi i Partise "LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM" bazuar ne librin e llogarive dhe të regjistrit të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, të cilët janë mbajtur për të pasqyruar të gjithë transaksionet në lidhje me fushatën zgjedhore, që kanë dhënë bazën për auditimin. Politika e ndjekur nga ana e drejtimit eshte , te pergatise pasqyrat mbi bazen e fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te realizuara gjate periudhes se fushates zgjedhore . Mbi kete baze , fondet e perfituara njihen kur fitohen ne leke ose ne material dhe sherbime te konvertuara dhe shpenzimet njihen si te tilla ne momentin qe ato jane kryer dhe jo kur ato paguhen.

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer.

Ne kemi kryer auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit në referencë të vecantë me SNA 800 "Konsiderata të vecanta-Auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qëllime specifike". Këto standarte kërkojnë që ne të veprojmë në pajtim me kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për faktin që pasqyra financiare e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të mos përmbajë anomali materiale. Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë auditimi në lidhje me shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyra. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit dhe përfshijnë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrës përkatëse, qoftë për shkak të mashtrimit, ashtu dhe të gabimit. Për vlerësimin e këtyre rreziqeve, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm të drejtimit që ka të bëjë me përgatitjen e pasqyrës me qëllim që ai të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të saj. Auditimi përfshin gjithashtu shqyrtimin mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në aktivitetin financiar, vlerësimin e parimeve të përdorura të vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi.

Ne çmojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas mendimit tonë, pasqyrat dhe evidencat mbështetese të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore në Zgjedhjet për Kuvend në datë 23 Qershor 2013 nga Partia "LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM", paraqesin në mënyrë të sinqerte, në të gjithë aspektet materiale fondet e përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për Zgjedhjet për Kuvend 2013.

Tirane me 24.09.2013

Eksperte Kontabel e Regjistruar

Stoli LAZE

RAPORT I AUDITIT TE PAVARUR MBI ANGAZHIMET E AUDITIMIT PER QELIME TE VECANTA.

MBI AUDITIMIN E FONDEVE TE PERFITUARA
NE FUSHATEN PER ZGJEDHJET PER KUVEND MAJ-QERSHOR 2013,
NGA SUBJEKTI PARTIA LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM

ANEKSI I PARE

INFORMACIONE TE PERGJITHSHME

1. OBJEKTI I AUDITIMIT

Fondet publike dhe jo publike te perfituara dhe te shpenzuara nga subjekti per fushaten zgjedhore per Zgjedhjet per Kuvend 2013.

2. SUBJEKTI I AUDITIMIT

Subjekti **Partia LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM**, per Zgjedhjet per Kuvend 2013.

3. INFORMACION MBI AUDITIMIN

- a) Auditimi eshte mbeshtetur ne dokumentacionin financiar te kesaj periudhe per periudhen (Maj-Qershor 2013).
- b) Auditimi eshte mbeshtetur ne kerkesat e LIGJIT Nr.10019, datë 29.12.2008 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË" i ndryshuar.

4. PERIUDHA E AUDITIMIT

Shtator 2013

5. PERSONAT E KONTAKTUAR PER AUDITIMIN

Emri Mbiemri	Jorida PRIFTI
Pozicioni/Titulli	Koordinator e Partise
Emri Mbiemri	Helena GACE
Pozicioni/Titulli	Pergjegjese e Finances
Emri Mbiemri	Luan RAMA
Pozicioni/Titulli	Sekretar i Pergjithshem

ANEKSI I DYTE

ZBATIMI I KUADRIT LIGJOR

1. Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet publike

Ne LIGJIN Nr.10 019, datë 29.12.2008 KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË i ndryshuar, Neni 87 "Shpërndarja dhe rishpërndarja e fondeve publike për subjektet zgjedhore" pika 2 shpreh " Sasia e fondeve publike që i shpërndahet secilit prej subjekteve zgjedhore caktohet me vendim të KQZ-së, sipas rregullave të mëposhtme"

Konstatohet:

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti ka qene perfitues i fondeve publike per Zgjedhjet per Kuvend 2013 ne masen 3,100,410 leke te cilat jane arketuar ne llogarine bankare.

2. Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike

Ne LIGJIN Nr.10 019, datë 29.12.2008 KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË i ndryshuar, Neni 89 "Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike" Neni 90 "Regjistrimi i fondeve jopublike" *konstatohet se:*

Neni 89 pika 1 shpreh:

Subjektet zgjedhore mund të marrin, për qëllime të fushatës së tyre zgjedhore, fonde vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas. Për qëllim të këtij Kodi, konsiderohet person fizik vendas edhe shtetasi shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Konstatohet:

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti ka qene perfitues i fondeve per qellime te fushates zgjedhore nga persona fizike apo juridike vendas kjo sipas deklarimit te perfaqesuesit si dhe te regjistrit te dhurimeve apo prej historikut te llogarise bankare.

Neni 89 pika 2 shpreh:

Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t'i dhuroj një subjekti zgjedhor nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlehtë në sende ose shërbime.

Konstatohet:

Subjekti ka qene perfitues i fondeve per qellime te fushates zgjedhore nga persona fizike apo juridike vendas dhe nga verifikimet e kryera shumat e dhuruara nuk jane me te medha se 1 milion leke.

Neni 89 pika 3 shpreh:

Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:

- a) ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë;
- b) ushtron veprimtari në fushën e medias;
- c) ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;
- ç) ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.

Neni 90 pika 1 shpreh:

Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin qartë të dhuruesit. Në çastin e dhurimit, dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e përcaktuara në nenin 89 të këtij Kodi dhe mban përgjegjësi personale për deklaram të rremë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohet nga KQZ-ja dhe është e detyrueshme për t'u nënshkruar në çdo rast dhurimi. Lista e personave që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse duhet të bëhen kurdoherë publike.

Konstatohet:

Nga verifikimet e kryera rezulton se prane subjektit zgjedhor dhuruesit kane plotesuar DEKLARATEN tip te miratuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor persa i perket konfliktit te

interesit per financimin e subjekteve zgjedhore. Ne perputhje me nenin 90, subjekti zgjedhor ka mbajtur regjister te posaçem sipas modelit te miratuar nga KQZ-ja.

Neni 90 pika 2 shpreh:

Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor. Përgjegjësi i financës së subjektit zgjedhor, jo më vonë se tre ditë nga fillimi i fushatës zgjedhore, deklaron numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Konstatohet:

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti zgjedhor e ka krijuar llogarine e vecante bankare per fonde per qellim te fushates zgjedhore dhe dhurimet jane kryer ne kete llogari sipas parashikimeve ligjore.

Neni 90 pika 3 shpreh:

Shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike, përfshirë edhe kandidatët e tyre, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike, sipas nenit 87 të këtij Kodi. Çdo shpenzim i kryer për fushatën zgjedhore dokumentohet dhe kryhet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi.

Konstatohet:

- Subjekti ka perfituar fonde publike dhe per rrjedhoje shpenzimet e kryera mund ti nenshtrohen krahasimit ne perputhje me piken 3 te nenit 90.
- Shpenzimet e kryera jane ne perputhje me legjislacionin tatimor ne fuqi.

Tirane me 24.09.2013

Eksperte Kontabel e Regjistruar

Stoli LAZE

PARTIA “LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM”

Pasqyrat e fondeve te perftuara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore ne Zgjedhjet per Kuvend 2013

**Pasqyrat e fondeve te perftuara dhe shpenzimeve te kryera
gjate fushates zgjedhore 2013 dhe shenimet shpjeguese**

PARTIA “LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM”
PASQYRA E FONDEVE TE PERFTUARA DHE SHPENZIMEVE TE KRYERA
GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2013

PERSHKRIMI SIPAS NATYRES

REF	NATYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	VLERA	%
1	FONDET E PERFITUARA		
1.1	Nga fondet publike	4,100,410	16.19%
1.1.1	Fondi per Fushaten Zgjedhore 2013	3,100,410	75.61%
1.1.2	Fondi i permuajshem	1,000,000	24.39%
1.2	FONDET JO PUBLIKE (ne vlere monetare)	1,418,089	5.60%
1.2.1	<i>Donacione nga persona fizike dhe juridike vendas ne llogarine e Fushates Zgjedhore</i>	<i>1,151,600</i>	<i>81.21%</i>
1.2.1.1	Rexhep BALLMI	200,000	17.37%
1.2.1.2	Aldit TABAKU	750,000	65.13%
1.2.1.3	Donacionet me vlere me te vogel se 100,000 leke	201,600	17.51%
1.2.2	<i>Mjete monetare te krijuara nga aktiviteti i subjektit zgjedhor</i>	<i>266,489</i>	<i>18.79%</i>
1.2.2.1	Fonde te krijuara nga kartat e anetaresise dhe kontributet e anetareve.	147,600	55.39%
1.2.2.2	Fonde te krijuara nga merreveshjet me palet e treat.	118,889	44.61%
1.3	Donacionet e perftuara ne sende dhe sherbime te vleresuara me vlere tregu	0	0
1.3.1		-	
1.4	Perfitim e nga reklama televizive sipas ne nit 84 , pika 6.	15,470,156	61.06%
1.4.1	TOP CHANNEL	14,931,495	96.52%
1.4.2	Media Vizion sha	538,661	3.48%
1.5	TE TJERA	4,345,713	17.15%
1.5.1	Mjete monetare gjendje ne fillim ne Arke	0	0.00%
1.5.2	Mjete monetare gjendje ne fillim ne Banke	4,345,713	100.00%
	SHUMA TOTALE E FONDEVE	25,334,368	100.00%

Pergjegjese e Finances
Helena GACE

Sekretar i prgjithshem i LSI-se
Luan RAMA

PARTIA “LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM”

Pasqyrat e fondeve te perftuara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore ne Zgjedhjet per Kuvend 2013

PERSHKRIMI SIPAS NATYRES

REF	SHPENZIMET E KRYERA PER FUSHATEN MAJ-QERSHOR 2013	VLERA	%
2.1	QERA SALLE PER FUSHATEN ZGJEDHORE	640,000	1.36%
2.1.1	Marrje salle me qera Pallati i Kongereseve	540,000	84.38%
2.1.2	Marrje salle me qera Pallati i Sporteve	100,000	15.63%
2.2	SPOTE PUBLIC ITARE	38,868,078	82.36%
2.2.1	Media Vizion SHA (Vizion +)	538,661	1.39%
2.2.2	TOP CHANNEL SHA	20,931,495	53.85%
2.2.3	Channel One SHA	5,658,307	14.56%
2.2.4	ORA SHA	11,316,614	29.12%
2.2.5	Media Content SHPK	423,000	1.09%
2.3	KONSULENCE PER FUSHATEN	-	0.00%
2.4	SHPENZIME TELEFONIKE	218,691	0.46%
2.4.1	Albtelecom	176,289	80.61%
2.4.2	ABCOM SHA	42,402	19.39%
2.5	FLAMUJ, BLUZA, POSTERA, FLETVOLANTE, FLETPALOSJE, REKLAME, BANDEROLA E MATERIALE TE TJERA	5,200,927	11.02%
2.5.1	Diart Company SHPK	630,000	12.11%
2.5.2	Univers Reklama SHPK	1,752,927	33.70%
2.5.3	Bledi Bashllari	400,000	7.69%
2.5.4	OLA 1 SHPK	1,500,000	28.84%
2.5.5	Redin Zylfo	300,000	5.77%
2.5.6	Bukurije Daja	300,000	5.77%
2.5.7	Hatixhe Shaba	318,000	6.11%
2.6	SHPENZIM E KANCELARIE E TE NGJASHME	281,962	0.60%
2.6.1	Klass sh .p .k , Shtypshkrime	281,962	100.00%
2.7	TE TJERA	400,000	0.85%
2.7.1	Sherbim me foni ndricim pode ne aktivitetet e fushates	400,000	100.00%
2.8	SHPENZIM E PER SHERBIME TE TJERA	296,265	0.63%
2.8.1	Sherbime Postare Filiali Qendra Tranzit	15,840	5.35%
2.8.2	Ujesjelles Kanalizime SHA	25,340	8.55%

PARTIA “LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM”

Pasqyrat e fondeve te perftuara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore ne Zgjedhjet per Kuvend 2013

2.8.3	CEZ Shperndarje SHA	249,935	84.36%
2.8.3	Komisione e shpenzime bankare	5,150	1.74%
2.9	SHPENZIME PER PERSONELIN MAJ QERSHOR 2013	1,288,436	2.73%
2.9.1	Pagat e punonjesve	938,450	72.84%
2.9.2	Sigurimet shoqerore e shendetsore	247,986	19.25%
2.9.3	Tatimi mbi te ardhurat personale	102,000	7.92%
	TOTALI I SHPENZIMEVE PER FUSHATEN	47,194,359	100%

Pergjegjese e Finances
Helena GACE

Sekretar i prgjithshem i LSI-se
Luan RAMA

PARTIA "LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM"**Pasqyrat e fondeve te perftuara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore ne Zgjedhjet per Kuvend 2013****Furnitoret e krijuar gjate fushates per Zgjedhjet per Kuvend 2013**

Nota	Fature Tatimore Shitje Nr. Date.	Furnitori	Vlera ne leke	Likuiduar deri ne 23.06.2013	Likuiduar pas dates 23,06,2013	Donacionet e perftuara ne sende dhe sherbime	Pa likuiduar	Shenim
	1304-154709-1-1	30,04,13	Ujesjelles Kanalizime Tirane	11,750	11,750			Credins (105129)
		30,04,13	CEZ Shperndarje	122,823	122,823			Raiffaisen bank
	710913718	08,05,13	Albtelekom	35,672	35,672			Credins (105129)
	1	21,05,13	Bledi Bashllari	400,000	400,000			Credins (105129)
		31,05,13	Pagat e punonjesve	469,225	469,225			Credins (105129)
	28	05,06,13	D.SH.Q	54,000	54,000			Credins (105129)
		10,06,13	Sigirimet Shoqerore e Shendetsore	123,993	123,993			Credins (105129)
		10,06,13	Tatimi mbi pagat	51,000	51,000			Credins (105129)
	506	31,05,13	Klass sh.p.k	281,962	281,962			Credins (105129)
	59	12,06,13	Qendra Sportive	100,000	100,000			Credins (105129)
		31,05,13	CEZ Shperndarje	127,112	127,112			Credins (105129)
	105237056	20,06,13	ABCOM	42,402	42,402			Credins (105129)
	1305-154709-1	30,05,13	Ujesjelles Kanalizime Tirane	13,590	13,590			Credins (105129)
	715392260	31,05,13	Albtelekom	140,616	140,616			Credins (105129)
		28,06,13	Pagat e punonjesve	469,225	469,225			Credins (105129)
	18	09,06,13	Redi Zylfo	300,000	300,000			Credins (105129)
	65	10,06,13	Bukurije Daja	300,000	300,000			Credins (105129)
	141	18,06,13	Ola 1 sh.p.k	1,500,000	1,500,000			Credins (105129)
		03,07,13	Sigirimet Shoqerore e Shendetsore	123,993	123,993			Credins (105129)
		03,07,13	Tatimi mbi pagat	51,000	51,000			Credins (105129)
	217	13,06,13	Media Vizion sh.a	538,661	538,661	50% kohe		Credins (499499)
	19	03,06,13	Driart-company	630,000	630,000			Credins (499499)

PARTIA “LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM”**Pasqyrat e fondeve te perftuara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore ne Zgjedhjet per Kuvend 2013**

	659	13,06,13	Univers Reklama	1,752,927		1,752,927			Credins (499499)
	69	07,06,13	Media Content sh.p.k	423,000		423,000			Credins (499499)
	38	20,06,13	Efekt sh.p.k	400,000		400,000			Credins (499499)
	29	10,06,13	D.SH.Q	486,000		486,000			Credins (499499)
	165	08,07,13	Filiali Qendra Tranzite	15,840		15,840			Credins (499499)
	48	11,06,13	Hatixhe Shaba	318,000		318,000			Raiffaisen bank
	836	22,06,13	TOP CHANNEL	20,931,495			14,931,495	6,000,000	
	6	14,06,13	Channel One	5,658,307				5,658,307	
	112	14,06,13	ORA sh.a	11,316,614				11,316,614	
	Totali i furniturave			47,189,209	1,650,425	7,632,367	14,931,495	22,974,922	

Llogarite prane bankave dhe levizja e tyre gjate periudhes 20/05/2013 DERI ME 10/07/2013

Nr.	Banka	Pershkrimi	Nr. i llogarise	20/05/2013	Hyrjet	Daljet	10/07/2013
1	Credins Tirana 1	Llogari e hapur per fushaten LEKE	00000499499	0.00	4,252,174	4,248,028	4,146
2	Credins Tirana 1	Llogari rrjedhse LEKE	00000105129	3,882,785	1,136,890	4,598,941	420,734
3	Raiffeisen Bank	Llogari rrjedhse LEKE	001-401513	462,927	129,600	440,973	151,554
4				4,345,713	5,518,664	9,287,942	576,434

Pergjegjese e Finances
Helena GACE

Sekretar i prgjithshem i LSI-se
Luan RAMA

PARTIA “LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM”

Shenime per pasqyrat financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera, ne fushaten zgjedhore 2013

I. Te Pergjithshme

Partia “Levizja Socialiste per Integrim” – LSI-a, e krijuar me vendim gjykate Nr. 4274 date 23.09.2004, i ndryshuar me Nr 4262 Akti dhe 471 Vendimi date 27/01/2009, eshte nje organizate politike e pavarur krijuar ne konformitet te plote me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe legjislacionin ne fuqi. Qellimi dhe objektivat e kesaj partie te percaktuara ne program e statut synojne ne realizimin e aspirates per nje Atdhe qe rilind e perparon drejt qellimeve te medha per nje zhvillim te balancuar te vendit, per ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave njerezore, per lartesimin e integritetit dhe dinjitetit kombetar, per integrim te shpejte ne familjen europiane, per marredhenie shoqerore, dinjitet dhe paqe. Partia “Levizja Socialiste per Integrim” synon te ndikojne ne jeten e vendit nepermjet pjesemarrjes ne zgjedhjet dhe perfaqesimit te popullit ne organet e zgjedhura te pushtetit.

- Partia “Levizja Socialiste per Integrim” eshte regjistruar si person juridik me iniciale L.S.I.

- Qellimi i saj eshte percaktuar ne akt themelimi dhe statut

- Gjithashtu ne statut jane percaktuar te drejtat dhe detyrat e anetareve te partise

- Organet drejtuese ne nivel qendror te partise jane : Konventa Kombetare (K.K)

Komiteti Drejtues Kombetar (K.D.K.) Kryesia

Kryetari

Nenkryetari

Sekretari i Pergjithshem

- Burimet financiare te Partise jane:

Te ardhurat nga kuotizacionet.

Te ardhurat nga buxheti i shtetit ne perputhje me legjislacionin per financimin e partive politike.

Ndihmat dhe dhuratat e anetareve e perkrahesve te LSI-se. Ndihmat dhe dhuratat e organizatave partnere.

Cdo e ardhur tjeter qe nuk bie ne kundershtim me legjislacionin per financimin e partive politike.

- Selia e Partise eshte ne Tirane ne adresen Rr.”Sami Frasheri “.Godina 20/10.

- Numri i anetareve te Partise eshte mbi 3000 shtetas shqiptar me banim te perhershem ne Republikën e Shqiperise.

PARTIA “LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM”

Shenime per pasqyrat financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera, ne fushaten zgjedhore 2013

II. Rregullat e Vleresimit

Menyra e pregatitjes se Pasqyrave Finaciare

Kontabiliteti eshte i ndertuar mbi bazen e parimeve te konstatimit. Sipas kesaj menyre fondet e perfituara ne te holla jane regjistruar ne momentin e arketimit te tyre dhe fondet e perfituara ne forme materiale dhe sherbimi ne mometin e kryerjes duke i konvertuar ne vlere leku dhe shpenzimet jane pasqyruar ne momentin e konstatimit te tyre kur jane kryer.

Monedha Raportuese

Partia ka perdorur ALL si monedha e baze e raportimit.

Fondet e pefituara jane mare ne leke ose ne forme materiale dhe sherbime.

Shpenzimet jane kryer ne ALL, por edhe ne EURO apo USD te cilat jane konvertuar me kursin e dites.

Taksat dhe Kontributet

Partia eshte e perjashtuar nga taksat mbi fitimin. Partia i ka shlyer detyrimet qe lindin per Sigurimet shoqerore dhe shendetesore te punonjesve dhe per tatimin mbi te ardhurat personale.

1. FONDET E PERFITUARA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2013.

1.1 FONDET PUBLIKE

1.1.1 Me daten 28/06/2013 jane kaluar ne llogari prane CREDINS Bank nga Dega e Thesarit Tirane shuma 3,100,410 leke si shtese fondi per fushaten zgjedhore ne mbeshtetje te shkreses urdher shpenzim i dates, dates 27/06/2013.

PARTIA “LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM”

Shenime per pasqyrat financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera, ne fushaten zgjedhore 2013

1.1.2 Me daten 14/06/2013 jane kaluar ne llogari prane CREDINS Bank nga Dega e Thesarit Tirane shuma 1,000,000 leke si fondi i perhershem i perfituar nga partia ne mbeshtetje te urdher shpenzimit te dates 13/06/2013.

1.2 FONDET JO PUBLIKE (ne vlere monetare)

1.2.1 Donacione nga persona fizike dhe juridike vendas ne llogarine e Fushates Zgjedhore

1.2.1.1 Me daten 11/06/2013 jane derdhur prane BANKES CREDINS, ne numrin e llogarise 499499, shuma 200.000 leke, si kontribut per fushaten zgjedhore te LSI-se nga Z. Rexhep Ballmi i cili ka nenshkruar nje deklarate nen pergjegjesine e tij qe eshte ne djeni te ndalimeve te percaktuara ne nenin 89 te ligjit nr. 10019, date 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor“.

1.2.1.2 Me daten 11/06/2013 jane derdhur prane BANKES CREDINS, ne numrin e llogarise 499499 shuma 750.000 leke, si kontribut per fushaten zgjedhore te LSI-se nga Z. Aldit Tabaku i cili ka nenshkruar nje deklarate nen pergjegjesine e tij qe eshte ne djeni te ndalimeve te percaktuara ne nenin 89 te ligjit nr. 10019, date 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor“.

1.2.1.3 Ne data te ndryshme jane derdhur BANKES CREDINS, ne numrin e llogarise 499499 shuma te ndryshme nen shumen 100.000 leke qe ne total jane 201.600 leke si kontribute per fushaten zgjedhore te LSI-se.

1.2.2 Mjete monetare te krijuara nga aktiviteti i subjektit zgjedhor

1.2.2.1 Shuma prej 147,600 leke e paraqitur ne pasqyren e mesiperme perfaqeson fondet e krijuara nga kartat e anetaresise dhe kontributet e anetareve. E gjithë shuma e mesiperme eshte derdhur ne llogarite bankare perkatese.

PARTIA “LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM”

Shenime per pasqyrat financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera, ne fushaten zgjedhore 2013

1.2.2.2 Shuma prej 147,600 leke e paraqitur ne pasqyren e mesiperme perfaqeson fondet e krijuara nga marreveshjet me palet e treta ne kete rast me Albtelecom Sh.A. dhe Filiali Qendra Tranzit, burime keto te derdhura ne llogarine bankare te partise.

1.3 DONACIONE E PERFITUARA NE SENDE DHE SHERBIME

Nuk konstatohen donacione te perfituara ne sende dhe sherbime te vleresuara me vlere tregu .

1.4 PERFITIME NGA REKLAMA TELEVIZIVE SIPAS NENIT 84 , PIKA 6 TE KODIT ZGJEDHOR

1.4.1 **TOP CHANNEL** , per transmetimin e reklamave televizive dhe radiofonike , te pranuar me fature , ka faturuar me shume se 50% te kohes se transmetimit falas ne shumen 14.931.495 leke.

1.4.2 **Media Vizion sh.a** , per transmetimin e reklamave televizive te pranuar me pagese ne baze te nenit 84 , pika 6 te Kodit Zgjedhor , ka faturuar edhe 50% te kohes se transmetimit falas ne vleften 538.661 leke , te cilen nuk e ka shprehur ne fature por eshte shenuar koha e perfituar teper.

1.5 TE TJERA

1.5.1 Ne fillim por edhe ne vijim nuk ka patur gjendje apo transaksione nga Arka

1.5.2 Gjendja ne fillim e mejeteve monetare ne Banke ne te gjitha llogarite bankare ka qene ne shume 4,345,713 leke shume e cila eshte vene ne dispozicion te fushates duke qene burim finacimi.

PARTIA “LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM”

Shenime per pasqyrat financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera, ne fushaten zgjedhore 2013

2. SHPENZIMET E KRYERA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2013

2.1 Marrje salle me Qera.

2.1.1 Drejtoria e Sherbimeve Qeveritare ka leshuar dy fatura tatimore shitje perkatesisht nr.28 date 05/06/2013 ne vleren 54,000 leke dhe nr 29 date 10/06/2013 ne vleren 486.000 leke , per marrje salle me qera , salla e madhe e koncerteve ne Pallatin e Kongreseve per hapjen zyrtare te fushates zgjedhore te LSI-se , shume e cila eshte likujduar nga llogarite bankare 499499 e 105129 ne Banka Credins respektivisht ne daten 06/06/2013 dhe ne daten 10/07/2013.

2.1.Qendra Sportive Sh.A. ka leshuar nje fature tatimore shitje me nr.59 date 12/06/2013 ne vleren 100,000 leke , per marrje salle me qera , salla e madhe e Pallatit te Sporteve “Asllan Rusi” per fushaten zgjedhore te LSI-se , shume e cila eshte likujduar nga llogaria bankare ne Banka Credins ne daten 13/06/2013 .

2.2 REKLAMA TELEVIZIVE DHE TRANSMETIME SPOTESHPUBLICITARE

2.2.1 MEDIA VIZION Sha ka leshuar fature tatimore shitje me nr 217 date 13/06/2013 ne te cilen ka faturuar transmetimin e spoteve ne vleren 538.661 leke , ne fature eshte vendosur edhe koha falas sipas kodit zgjedhor neni 84 por e cila nuk eshte faturuar ne vlere ne shumen 538,661 leke. Nuk konstatohet ndonj kontrate e lidhur mes paleve , per detyrimet reciproke.

2.2.2 TOP CHANNEL ka leshuar fature tatimore shitje me nr 836 date 22/06/2013 ne te cilen ka faturuar transmetimin e spoteve ne vleren 6.000.000 leke , ne fature eshte vendosur edhe koha falas sipas kodit zgjedhor neni 84 por e cila eshte me e madhe se 50% ne vleren 14.931.495 leke. Ne total shpenzimi eshte 20.931.495 Leke . Nuk konstatohet ndonj kontrate e lidhur mes paleve , per detyrimet reciproke.

2.2.3 Televizioni CHANNEL ka leshuar faturen tatimore shitje nr 06 date 14/06/2013 ne te cilen ka faturuar transmetimin e spoteve publicitare ne vleren 40,005 Euro te konvertuara me

PARTIA “LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM”

Shenime per pasqyrat financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera, ne fushaten zgjedhore 2013

kursin e dites jane 5.658.307 leke. Fatura nuk permban elemente qe tregojne se eshte dhene kohe falas ne respect te Kodit Zgjedhor. Ne total shpenzimi eshte 5.658.307 leke.

2.2.4 Televizioni ORA ka leshuar nje fature tatimore shitje nr 112 date 14/06/2013 ne te cilen ka faturuar transmetimin e spoteve ne vleren 80.010 Euro te konvertuara me kursin e dites jane 11.316.614 leke. Fatura nuk permban elemente qe tregojne se eshte dhene kohe falas ne respect te Kodit Zgjedhor. Ne total shpenzimi eshte 11.316.614 leke.

2.2.5 MEDIA CONTENT SHPK ka leshuar faturat tatimore shitje nr 69 date 07/06/2013 ne te cilen ka faturuar Hapsire Publicitare ne vlefte 423,000 leke . .Ne total shpenzimi eshte 423,000 leke. Nuk konstatohet ndonj kontrate e lidhur mes paleve , per detyrimet reciproke.

2.3 KONSULENCE E HUAJ PER FUSHATEN.

Nuk eshte konstatuar ndonje shpenzim per konsulence per fushaten zgjedhore 2013.

2.4 SHPENZIME TELEFONIKE

2.4.1 Sipas faturave te ALBTELECOM sha gjate muajve Maj – Qershor shpenzimet per telefonat fiks kapin vleren 176,289 leke te cilat jane konsideruar si shpenzime te fushates zgjedhore 2013.

2.4.2 Sipas kontrates se lidhur midis paleve por edhe nepermjet faturave te permuajshme shpenzimi per internetin dhe sherbime te lidhura ka qene ne vleren 42.402 leke te cilat jane perfshire ne shpenzimet e fushates zgjedhore 2013.

PARTIA “LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM”

Shenime per pasqyrat financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera, ne fushaten zgjedhore 2013

2.5 SHPENZIME PER FLETEVOLANTE, FLETEPALOSJE, REKLAMA,BANDEROLA

2.5.1 Sipas fatures tatimore shitje nr 19 date 03/06/2013, Diart Company shpk ka faturuar per blerje flamur te qepur ne vleren 630,000 leke te pergatitur per fushaten zgjedhore 2013.

2.5.2 Sipas fatures tatimore shitje nr 659 date 13/06/2013, UNIVERS REKLAMA sh.p.k ka faturuar vleren 1,752,927 leke per printim ne adeziv postera dhe banera te pergatitura per fushaten zgjedhore 2013.

2.5.3 Sipas fatures tatimore shitje nr 1 date 21/05/2013, BLEDI BASHLLARI ka faturuar vleren 400,000 leke per blerje bluzash te pergatitura per fushaten zgjedhore 2013.

2.5.4 Sipas fatures tatimore shitje nr 141 date 18/06/2013, OLA 1 sh.p.k ka faturuar vleren 1,500,000 leke per printime dhe blerje bluza e kapele te pergatitura per fushaten zgjedhore 2013.

2.5.5 Sipas fatures tatimore shitje nr 18 date 09/06/2013, REDIN ZYLFO ka faturuar 300,000 leke per printime ne banera dhe adeziv te pergatitura per fushaten zgjedhore 2013.

2.5.6 Sipas fatures tatimore shitje nr 65 date 10/06/2013, BUKURIJE DAJA ka faturuar vleren 300,000 leke per printime dhe blerje bluzash te pergatitura per fushaten zgjedhore 2013.

2.5.7 Sipas fatures tatimore shitje nr 48 date 11/06/2013, HATIXHE SHABA ka faturuar vleren 318,000 leke per blerje flamur me logon e LSI-se te pergatitur per fushaten zgjedhore 2013.

2.6 SHPENZIME KANCELARIE

2.6.3 Sipas fatures tatimore nr 506 date 31/05/2013 KLASS sh.p.k , ka faturuar ne vleren 281,962 leke per shtypshkrimet e perdorura ne fushaten zgjedhore.

PARTIA “LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM”

Shenime per pasqyrat financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera, ne fushaten zgjedhore 2013

2.7 TE TJERA

2.7.1 Sipas fatures tatimore nr. 38 date 20/06/2013, EFEKT sh,p,k ka faturuar vleren 400,000 leke per sherbime me foni ndricim pode ne aktivitetet e fushtes zgjedhore 2013.

2.8 SHPENZIME PER SHERBIME TE TJERA

2.8.1 Sipas fatures tatimore nr. 165 date 08/07/2013, Filiali Qendra Tranzit (Posta Shqiptare) ka faturuar ne vleren 15,840 leke sherbimet te perdorura ne fushaten zgjedhore 2013, dhe eshte konsideruar si shpenzim per fushaten.

2.8.2 Sipas faturve tatimore te leshuara nga UKT Sh.a. eshte faturuar gjate fushates shuma 25,340 leke per konsumin e ujit dhe eshte konsideruar si shpenzim per fushaten 2013.

2.8.3 Sipas faturve tatimore te leshuara nga CEZ Shperndarje Sh.a. eshte faturuar gjate fushates shuma 249,935 leke per konsumin e energjise elektrike dhe eshte konsideruar si shpenzim per fushaten 2013.

2.8.3 Sipas historikeve te llogarive bankare gjate fushates eshte shpenzuar shuma 5,150 leke per sherbime bankare dhe eshte konsideruar si shpenzim per fushaten 2013.

2.9 PAGAT E PUNONJESVE DHE KONTRIBUTET.

2.9.1 Pagat e punonjesve te muajve Maj e Qershor 2013 ne vleren 938,450 leke jane konsideruar si shpenzime te fushates zgjedhore 2013.

2.9.2 Sigurimet shoqerore dhe shendetesore te muajve Maj e Qershor 2013 ne vleren 247,986 leke jane konsideruar si shpenzime te fushates zgjedhore 2013.

PARTIA “LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM”

Shenime per pasqyrat financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera, ne fushaten zgjedhore 2013

2.9.3 Tatimi mbi te ardhurat personale te muajve Maj e Qershor 2013 ne vleren 102,000 leke jane konsideruar si shpenzime te fushates zgjedhore 2013..

3. LLOGARITE BANKARE DHE LEVIZJA E TYRE GJATE PERIUDHES 20/05/2013 DERI ME 10/07/2013 (per arsye te koheshtrirjes se likujdimeve) .

Gjendja e likuiditeteve ne banke 20/05/2013 , eshte e ndare si me poshte:

Nr.	Banka	Pershkrimi	Nr. i llogarise	20/05/2013
1	Credins Tirana 1	Llogari e Fushates ALL	00000499499	0.00
2	Credins Tirana 1	Llogari rrjedhse ALL	00000105129	3,882,785
3	Raiffeisen Bank	Llogari rrjedhse ALL	001-401513	462,927
TOTALI				4,345,713

Partia Levizja Socialiste per Integrim gjate fushates 2013 ka operuar ne keto llogari bankare: dy llogari prane Bankes Credins (dy ne ALL) nje llogari prane Raiffeisen Bank ne ALL.

Llogarite e celura prane bankave dhe levizja e tyre gjate periudhes 20/05/2013- 10/07/2013

Nr.	Banka	Pershkrimi	Nr. i llogarise	20/05/2013	Hyrjet	Daljet	10/07/2013
1	Credins Tirana 1	Llogari e fushates ALL	00000499499	0.00	4,252,174	4,248,028	4,146
2	Credins Tirana 1	Llogari ALL	00000105129	3,882,785	1,136,890	4,598,941	420,734
3	Raiffeisen Bank	Llogari ALL	001-401513	462,927	129,600	440,973	151,554
TOTALI				4,345,713	5,518,664	9,287,942	576,434

Levizja e cash flow gjate fushates elektorale

Pershkrimi	LEKE	EURO	TOTAL
Gjendja ne daten 20/05/2013	4,345,713	0,00	4,345,713
Hyrjet gjate fushates	5,518,664	0,00	5,518,664
Daljet gjate fushates	9,287,942	0,00	9,287,942
Gjendja ne daten 10/07/2013	576,434	0,00	576,434

PARTIA “LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM”

Shenime per pasqyrat financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera, ne fushaten zgjedhore 2013

4. REGJISTRIMI I FONDEVE JOPUBLIKE

Regjistrimi i fondeve jopublike te perfituara gjate fushates zgjedhore 2013 eshte bere ne rregjistrin e posaçem, sipas modelit te miratuar me vendim te KQZ-se duke pasqyruar te gjitha shumat e perfituara si dhe te dhena te tjera qe lidhen me identifikimin e qarte te dhuruesit.

Ne çastin e dhurimit, ata kane nenshkruar nje deklarate, ku zotohen se nuk ndodhen ne nje nga rrethanat e percaktuara ne nenin 89 te ketij Kodi dhe mbajne pergjegjesi personale per deklarate te rreme. Forma dhe permbajta e deklarave te nenshkruara eshte ajo e miratuar nga KQZ-ja. Dhurimi i fondeve publike eshte bere ne llogarine e posaçme te hapur prane Bankes Credins me Nr llogarie 499499, per te cilen kemi njoftuar dhe deklaruar prane KQZ-es. Donatoret i kane derdhur donacionet ne mjete monetare ne llogarine bankare.

Shpenzimet totale qe ka kryer LSI-ja per fushaten zgjedhore nuk e kalojne kufirin e percaktuar ne nenin 90 te ketij ligji. Te gjitha shpenzimet e kryera gjate fushates zgjedhore jane dokumentuar duke respektuar legjislacionin tatimor ne fuqi. Ne keto pasqyra jane perfshire te gjitha fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera nga LSI-ja per fushaten zgjedhore per Zgjedhjet per Kuvend 2013.

6. NGJARJE TE MEVONESHME

Per arsye te specifikave te vecanta te fushatave zgjedhore por edhe te politikave tregtare te paleve te treta me te cilat eshte bashkpunuar para, gjate dhe pas fushates ne pasqyrat e mesiperme eshte perfshire periudha kohore nga 20/05/2012 deri 10/07/2013. Fushata zyrtare eshte prej dates 23/05/2013 deri 23/06/2013 periudha e perfshire teper eshte pjese perberese e pasqyareve sepse eshte tregues i transaksioneve te konstatuar para apo pas fushates zyrtare po qe i perkasin perfitimeve dhe shpenzimeve per fushaten zgjedhore.

Pergjegjese e Finances

Helena GACE

Sekretar i prgjithshem i LSI-se

Luan RAMA